




**Kanton Zürich
Bildungsdirektion
Volksschulamt**

Nga shkolla primare në shkollën sekundare

Informacione për prindërit

Pas klasës së 6-te fëmija Juaj kalon nga shkolla fillore në shkollën sekundare (të shkollës popullore) apo në gjimnaz. Ky hap i rëndësishëm në karrierën e fëmijës Tuaj përgatitet dhe vendoset me kujdes të veçantë në klasën e 6-të së bashku me mësueset dhe mësuesit përgjegjës të fëmijës Tuaj.

Një pasqyrë e shkollës popullore në Kantonin e Cyrihut





Shkolla sekundare (Shkolla popullore)

Shkolla sekundare varësisht nga komuna ku graviton, ka dy: (A, B) apo tri (A, B, C) drejtime. Drejtimi A është me më së shumti kërkesa. Vendimin për atë se cilin drejtim do ta ndjekë fëmija Juaj e merr personeli mësimor së bashku me Ju në bisedën me prindërit. Bazë për zhvillimin e një bisede të tillë shërben vlerësimi i përgjithshëm i fëmijës Tuaj. Ky vlerësim përfshin rezultatet në mësim, qëndrimin e tij ndaj procesit të punës dhe mësimin dhe qëndrimin e tij social si dhe nivelin e tij të zhvillimit. Në rast se nuk arrini të bini dakord me vendimin e personelit mësimor mbi caktimin e fëmijës Tuaj në shkollën sekundare, vendos Këshilli gjegjës Shkollor (“Shulpflege”). Për të marrë parasysh qëndrimet e ndryshme të fëmijës në procesin e të mësuarit, shkollat sekundare mund të ofrojnë në më së shumti tri prej katër lëndëve mësimore: matematikë, gjermanisht, frëngjisht, tri nivele (I; II dhe III). Për atë se çfarë nivele kërkesash do të ofrojë një komunë vendos Këshilli Shkollor. Niveli I është me kërkesat më të larta. Fëmija Juaj përcaktohet në njërin prej tri niveleve varësisht nga rezultatet e tij në matematikë, gjermanisht, frëngjisht apo anglisht. Varësisht nga suksesi në mësim dhe gjendja zhvillimore e fëmijës Tuaj është i mundur edhe kalimi nga një nivel në tjetrin apo edhe i kalimit nga një shkallë kërkesash në një shkallë tjetër. Në vitin e parë janë paraparë tri terminë për këtë (fondi i nëntorit, mesi i prillit, fundi i vitit shkollor). Në vitet e tjera janë paraparë dy terminë për këtë (fondi i janarit dhe fundi i vitit shkollor). Për një kalim të tillë, kërkesën e bën zakonisht personeli mësimor. Ju si prind mund ta parashtroni po ashtu një kërkesë të tillë. Vendimin për këtë e merr personeli mësimor bashkë me Ju si prind. Në rast mospajtimi, vendos Këshilli Shkollor.

Procesi i mundshëm i kalimit nga një nivel në tjetrin apo nga një shkallë kërkesash në tjetrën

Në tremujorin e parë apo të dytë të klasës së 6-të të shkollës fillore

1. Në tremujorin e parë apo të dytë të klasës së 6-të të shkollës fillore

Shkolla i njofton prindërit mbi organizimin e shkollës sekundare si dhe mbi nivelet e ndryshme dhe të shkallëve.

Mesi i shkurtit

2. Mesi i shkurtit

Kujdestari i klasës zhvillon një bisedë mbi të ardhmen shkollore të fëmijës Tuaj.

Deri në fund të marsit

3. Deri në fund të marsit

Prindërit marrin propozimin mbi klasifikimin e fëmijës në ndonjëherë prej niveleve dhe e bisedojnë këtë propozim me fëmijën gjegjësisht. Nëse të gjithë të pranishmit janë të pajtimit, atëherë klasifikimi në shkollën sekundare konsiderohet i përmbyllur. Ky klasifikim bëhet i ditur përmes rrugëve zyrtare të komunikimit.

Në prill

4. Në prill

Në rast mospajtimi zhvillohet një bisedë e dytë me kujdestarin e klasës, me një anëtar të drejtorisë shkollore dhe me një mësues të shkollës sekundare. Në rast se arrihet pajtimi, klasifikimi në shkollën sekundare konsiderohet si i vlefshëm. Ky klasifikim bëhet i ditur përmes rrugëve zyrtare të komunikimit. Në rast mospajtimi, aktet i dorëzohen për një vendim përfundimtar Këshillit Shkollor.

maj/qershor

5. maj/qershor

Pas njohjes të së drejtës ligjore të dëgjimit, pason vendimi i Këshillit Shkollor për caktim në Shkollën Sekundare.



Gjimnazi (Shkolla e mesme)

Nëse fëmija Juaj bën pjesë në mesin e nxënësve dhe nxënësve me rezultate shumë të mira, ai mund që pas klasës së 6-të shkollës fillore ta ndjekë gjimnazin apo shkollën e mesme. Deri më 10 shkurt (për gjimnazin e sportive dhe atë të arteve deri më 15 janar) duhet ta lajmëroni fëmijën në ndonjërin prej gjimnazeve të përzgjedhjes Tuaj. Fëmija Juaj përcaktohet për njërin prej pesë profileve të maturitetit. Duhet të kalohet së pari provimi pranues. Notat e arritura në mësim në shkollat fillore publike merren parasysh. Si notë që merret parasysh nga klasa e 6-të e shkollës fillore është mesatarja e notës në gjermanisht dhe matematikë Fëmija Juaj testohet në njohuritë dhe shkathtësitë e arritura gjatë gjashtë viteve të shkollimit fillor të sistemit shkollor të Cyrihut deri në terminin e mbajtjes së provimit.

Kush mund t'ju japë informacione prindërve?

Si prind kontaktoni së pari mësuesin e fëmijës Tuaj. Komunitat shkollore kanë zakonisht ueb- faqen e tyre. Faqet e internetit të shkollave përmbajnë informacione të shumta për Ju.

Informacione të tjera

Për shkollën sekundare

Gjeni në ueb- faqen e Entit të Shkollimit Popullor të Drejtorisë së Arsimit:

www.zh.ch/volksschule → Sekundarschule

www.zh.ch/bildungsdirektion

Për ofertat e posaçme të përkrahjes:

www.zh.ch/volksschule → Besonderer Bildungsbedarf

Për kalim në gjimnaz

Në ueb-faqen e Entit për Shkollim të Mesëm dhe Profesional

www.zh.ch/mba

Këtu gjeni udhëzime për lajmërim dhe për hyrje në internet në të gjitha gjimnazet dhe në shkollat e tjera të mesme të Kantonit të Cyrihut. Informacione për lajmërim për provimin pranues gjeni në:

www.zentraleaufnahmepruefung.ch